



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit me numër 24-186/2, të datës 24.02.2025 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës, me titull ***“Ndryshimet kurrikulare në arsim fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej vitit 2010 deri në vitin 2021”***, të kandidatës Mr.sc. Rabije Osmani, komisioni në përbërje: Prof. dr. Besa Dogani - kryetar, Prof. dr. Rabije Murati -anëtar, Prof. dr. Lulzim Mehmedi - anëtar, Prof. dr. Valdeta Zenuni Idrizi - anëtar dhe Prof. dr. Besa Havziu Ismaili - anëtar, pasi e lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik i paraqet këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Punimi i disertacionit të doktoratës së kandidatës **Rabije Osmani** i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoratës, si në aspekt strukturor po ashtu edhe në aspekt përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor.

Lënda e hulumtimit:

Synimi drejt një sistemi botëror të arsimit të lartë dhe globalizimi i shoqërisë njerëzore është një realitet i pamohueshëm në ditët e sotme. Zhvillimi dinamik ekonomik dhe përparimet e teknologjisë së informacionit nuk i lejojnë as rajonet më të izoluara të shmangin ndikimin dhe presionet e globalizmit. Arsimi për zhvillim përfaqëson një qasje inovative ndaj të nxënit, e cila sfidon paradigmen tradicionale të zhvillimit dhe inkurajon ndryshimet e udhëhequra nga qytetarët dhe shoqëria, me synimin për një botë më të zhvilluar në arsim, edukim, civilizim dhe progres shoqëror. Arsimi është një element thelbësor i shoqërisë sonë, pasi pa një sistem arsimor të duhur,

brezat e rinj nuk do të mund të ndërtojnë një të ardhme të qëndrueshme në një botë gjithnjë e më komplekse. Ai përbën shtyllën themelore të një shoqërie në të gjitha dimensionet e saj.

Ky punim synon të japë përgjigje ndaj një sërë pyetjesh që po bëhen gjithnjë e më shumë objekt i ndryshimeve dhe rishikimeve të vazhdueshme në fushën e pedagogjisë. Pedagogjia, si një disiplinë shkencore më vete, trajton problematika pedagogjiko-didaktike që analizohen dhe zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me përparimet shkencore dhe shoqërore. Një nga sfidat kryesore në këtë kontekst është përcaktimi dhe përmbajtja e kurrikulës, një koncept i përdorur gjerësisht në literaturën e filozofisë pedagogjike, por që vjen me mbi 120 përkufizime të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri definicionesh reflekton zhvillimin e vazhdueshëm të kësaj fushe dhe përpjekjet për të zgjeruar njohuritë mbi kurrikulën, elementet e saj dhe dimensionet themelore që duhet të përfshihen në një përkufizim të vlefshëm. Termi "kurrikulum" rrjedh nga latinishtja e vjetër *curriculum*, që nënkupton "garë" apo "pistë garash". Kjo metaforë përfaqëson rrugëtimin arsimor dhe sfidat që hasen gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë lëndët mësimore që duhen përfunduar me sukses. Ky koncept mori hov të madh në shekullin XX dhe sot, ndonëse në vendin tonë nuk përdoret gjithmonë si term i veçantë, ai përfshin plan-programet për të gjitha lëndët mësimore, si ato obligative ashtu edhe ato zgjedhore, si dhe aktivitetet jashtëkurrikulare të organizuara në shkollë. Përmes kurrikulës përcaktohen detyrimet e nxënësve, angazhimi i tyre në procesin mësimor, metodat e të nxënës, matjet sasiore dhe cilësore të arritjeve të tyre, si dhe organizimi i përgjithshëm i sistemit arsimor. Këto elemente e bëjnë kurrikulën një komponent thelbësor në formësimin e një arsimi cilësor dhe të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Kurrikula nuk është një koncept i ri, megjithatë, ai është përdorur në mënyrë historike në të gjitha periudhat, duke filluar nga shkollat e qytetërimit perëndimor, të cilat ishin nën ndikimin e filozofisë së Platonit dhe Aristotelit. Në atë kohë, termi kurrikulë përdorej për të përshkruar lëndët klasike të qytetërimit grek. Në dy dekadat e fundit, ky koncept është përvetësuar si një terminologji profesionale në vendet e zhvilluara, duke shërbyer si një zëvendësim i termit tradicional "plani dhe programi mësimor". Kurrikula mësimore është dokumenti themelor zyrtar dhe shtetëror, i përgatitur posaçërisht për institucionet arsimore, duke përfshirë shkollat fillore, të mesme, profesionale dhe parashkollore. Në bazë të kurrikulës qendrore, hartohen edhe kurrikulat programore për çdo lëndë dhe vit shkollor. Si një dokument zyrtar, ajo përcakton lëndët e përfshira në çdo klasë, numrin e orëve të lëndëve të detyrueshme dhe atyre zgjedhore, aktivitetet e lira, mësimin shtues dhe plotësues, si dhe orët e klasës. Gjithashtu, pasqyron numrin e përgjithshëm të orëve javore dhe vjetore për çdo lëndë, strukturën dhe radhitjen e lëndëve mësimore, si dhe

organizimin e lëndëve zgjedhore dhe fakultative. Ndryshimet dhe inovacionet në kurrikulë janë të domosdoshme për t'iu përshtatur zhvillimeve të ndryshme politike, sociale, kulturore, ekonomike, shoqërore dhe teknologjike. Sistemi arsimor është i detyruar t'i nënshtrohet këtyre ndryshimeve për të reflektuar dhe adresuar nevojat emergjente të kohës. Megjithatë, ndryshimet ndodhin shpesh në jetën dhe procesin tonë të punës, por rrallëherë ndalemi për të reflektuar mbi arsyet, metodat dhe ndikimet e tyre. Çdo ndryshim duhet të analizohet dhe vlerësohet nga këshilltarët, arsimtarët dhe ekspertët e fushës përkatëse për të siguruar efektivitetin e tij.

Qëllimi i studimit

Ky studim trajton në mënyrë të thelluar cilësinë e ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor në periudhën 2010–2021. Ndërsa ka dëshmi për trajtimin e çështjes së ndryshimit të teksteve shkollore të Kembrixhit, mungon një hulumtim gjithëpërfshirës që shqyrton në detaje konceptet, programet, doracakët, udhëzuesit, tekstet dhe burimet e ofruara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZhA) dhe institucionet përkatëse. Për rrjedhojë, nevoja për një analizë të plotë dhe sistematike mbi këtë çështje është e evidente.

Kjo temë është trajtuar gjerësisht edhe në kontekstin e vendit tonë, ndërsa baza teorike mbi konceptin e kurrikulës dhe komponentët e saj mbështetet në punimet e autorëve si **R. Murati, Xh. Murati, B. Musai, N. Zabeli**, si dhe në dokumente zyrtare si **Planet Strategjike për Zhvillimin e Arsimit, Planet Zhvillimore, Konceptet për Arsimin Fillor, Programet Mësimore Tematike** etj. Në këtë kontekst, pas një analize të detajuar, ky studim ofron një përgjigje të argumentuar mbi ecurinë e ndryshimeve kurrikulare gjatë kësaj periudhe. Për të qenë sa më preciz, hulumtimi synon të analizojë **planifikimet afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra** për arsimin fillor, përfshirjen e **programeve mësimore, përmbajtjeve tematike, lëndëve obligative dhe zgjedhore**, si dhe integrimin e **aktiviteteve të lira dhe jashtëmësimore** në praktikë. Po ashtu, një dimension i rëndësishëm i studimit mbetet **vlerësimi i arritjeve të nxënësve në raport me objektivat kurrikulare**, duke synuar të vlerësojë nivelin e realizimit të qëllimeve të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Duke qenë se kurrikula përbën boshtin kryesor të procesit edukativ, rëndësia e këtij studimi qëndron në theksimin e rolit të saj për sigurimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës. Përveç funksionit të saj pedagogjik, kurrikula shërben si mekanizëm thelbësor për **promovimin e barazisë në një shoqëri të larmishme**, duke garantuar qasje të barabartë në arsim, pavarësisht përkatësisë etnike, statusit shoqëror, gjinisë apo faktorëve të tjerë diversivë. Ndryshimet dhe përshtatjet e kurrikulës janë të pashmangshme, për shkak të evolucionit të vazhdueshëm të shoqërisë dhe nevojës për një sistem arsimor dinamik dhe të përditësuar. Rëndësia e

pakontestueshme e kurrikulës paraqet shtyllën kryesore të kësaj teme disertacioni, dhe ka për qëllim të analizojë dhe të prezantojë **ndryshimet kurrikulare në arsimin fillor në Maqedoninë e Veriut gjatë viteve 2010–2021.**

Hulumtimi gjithashtu përqëndrohet në evolucionin e komponentëve kyç të sistemit arsimor, duke përfshirë:

- **Kurrikulat arsimore dhe përmbajtjet tematike**
- **Lëndët zgjedhore dhe aktivitetet jashtëmësimore**
- **Infrastrukturën dhe resurset shkollore**
- **Zhvillimin profesional dhe avancimin e kompetencave pedagogjike të mësimeve**

Në këtë kontekst, disertacioni me titull "**Ndryshimet kurrikulare në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2010–2021)**" trajton problematikat teorike, metodologjike dhe empirike të kësaj çështjeje. Ai përbëhet nga **240 faqe të ndara në pesë kapituj**, të cilët përfshijnë:

1. **Qasjen teorike mbi problemin e hulumtimit**
2. **Metodologjinë e përdorur në kërkim**
3. **Prezantimin dhe analizën e rezultateve të hulumtimit**
4. **Analizën kualitative të intervistave me këshilltarët e BZHA-së dhe pedagogët e shkollave**
5. **Diskutimin e rezultateve, përfundimet dhe rekomandimet**

Studimi përfshin gjithashtu **9 grafikone dhe 49 tabela**, duke ofruar dëshmi të qarta mbi ndikimin e ndryshimeve kurrikulare. Rezultatet e analizës tregojnë se ndryshimet e zbatuara në këtë periudhë nuk kanë sjellë përmirësimin e pritur në cilësinë e arsimit fillor. Për rrjedhojë, studimi ofron rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të politikave arsimore, duke adresuar sfidat e evidentuara dhe duke propozuar strategji për zhvillimin e një sistemi më efikas dhe të përshtatur me nevojat bashkëkohore. Struktura e këtij punimi është konceptuar në mënyrë të sistematizuar, duke përfshirë pesë kapituj që zhvillojnë në mënyrë të hollësishme kornizën teorike, metodologjinë kërkimore, analizën e rezultateve dhe përfundimet përkatëse.

Pjesa hyrëse ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi fushën shkencore të studimit, duke argumentuar nevojën dhe rëndësinë e hulumtimit, si dhe duke artikuluar qartësisht problemin e trajtuar. **Kapitulli i parë (fq. 13–18)** fokusohet në prezantimin e sfondit teorik të studimit, duke përfshirë bazat konceptuale dhe arsyet mbi të cilat është ndërtuar kërkimi.

Kapitulli i dytë (fq. 19–125) është më i gjerë në shtrirje dhe përfshin 13 seksione kryesore dhe 32 nënseksione. Ky kapitull analizon në mënyrë të thelluar qasjen teorike mbi problematikën e hulumtuar, duke u ndalur veçanërisht në evolucionin e tri modeleve kurrikulare të zbatuara gjatë periudhës 2010–2021. Analiza përfshin aspekte kyçe të sistemit arsimor si: programet mësimore, lëndët zgjedhore, aktivitetet jashtëkurrikulare, planifikimi i procesit mësimor (javor dhe ditor), përdorimi i teksteve digjitale, vlerësimi i kombinuar, kompetencat e mësimdhënësve dhe ndërlidhja e kurrikulës me teknologjinë.

Kapitulli i tretë (fq. 126–133) trajton metodologjinë e hulumtimit, duke përfshirë objektivat dhe pyetjet kërkimore, hipotezat dhe variablat e studimit, si dhe instrumentet e përdorura për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Përveç metodave kërkimore dhe karakterizimit të popullatës dhe kampionit, ky kapitull përshkruan edhe pritshmëritë mbi rezultatet e studimit.

Kapitulli i katërt (fq. 134–197) paraqet në mënyrë analitike rezultatet e hulumtimit. Fillimisht, jepet një përshkrim i karakteristikave socio-demografike të të anketuarve dhe shpërndarjes së variablave brenda kampionit. Më pas, realizohet interpretimi i hipotezave kërkimore, duke shqyrtuar dallimet në varësi të faktorëve të ndryshëm si: institucioni arsimor, niveli akademik, përvoja profesionale, vendbanimi, gjinia dhe ndjekja e programeve të trajnimit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet analizës cilësore të intervistave të zhvilluara me këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe pedagogët e shkollave fillore, të cilat ndihmojnë në interpretimin më të thelluar të ndryshimeve kurrikulare dhe ndikimit të tyre në cilësinë e arsimit.

Kapitulli i pestë (fq. 204–213) përmbyll studimin me një diskutim kritik të rezultateve, përfundimet kryesore të nxjerra nga hulumtimi dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore. Punimi mbështetet në një bazë të gjerë teorike dhe empirike, me **102 referenca bibliografike**, të cilat përfshijnë citime dhe parafrazime të burimeve relevante. Në fund, **shtojcat** përmbajnë instrumentet e përdorura në këtë studim, përfshirë **pyetësin për mësimdhënësit (fq. 223–234)** dhe **protokollet e intervistave me këshilltarët e BZHA-së dhe pedagogët e shkollave fillore (fq. 234–240)**. Ky punim shtron një analizë të hollësishme të reformave kurrikulare në arsimin fillor të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 2010–2021, duke integruar qasje teorike dhe metodologji të avancuara kërkimore për të ndriçuar efektet e këtyre ndryshimeve në cilësinë e arsimit dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Kapitulli i parë hapet me një hyrje të përgjithshme mbi temën e hulumtimit, duke ofruar një panoramë të gjerë mbi çështjet kyçe që trajtohen në këtë studim. Më tej, fokusohet në argumentimin e problematikës së hulumtimit, duke integruar perspektiva të ndryshme nga literatura vendase dhe ndërkombëtare. Një aspekt thelbësor i këtij kapitulli është përcaktimi i **qëllimit kryesor të kërkimit**, i cili konsiston në shqyrtimin dhe verifikimin e ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor. Ky shqyrtim përfshin analiza mbi strukturën e sistemit arsimor, programet dhe planet mësimore, lëndët zgjedhore, aktivitetet jashtëkurrikulare, përdorimin e teksteve digjitale si dhe zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve. Në mënyrë të veçantë, hulumtimi synon të identifikojë ndikimin e këtyre ndryshimeve në përmirësimin e cilësisë së arsimit, duke kontribuar në zhvillimin e politikave arsimore më efektive dhe në përmirësimin e praktikave pedagogjike.

Kapitulli i dytë përqendrohet në aspektin teorik të temës, duke shqyrtuar nocionet e kurrikulës dhe teoritë e ndryshme të autorëve të njohur, si dhe lidhjen midis ndryshimeve në arsim dhe inovacioneve arsimore. Pjesa e parë e kapitullit i dedikohet analizës së kurrikulës dhe elementëve kyç që mundësojnë hartimin e saj, duke u përqëndruar gjithashtu në faktorët që duhen marrë parasysh gjatë implementimit të ndryshimeve kurrikulare. Kjo përfshin llojet dhe karakteristikat e kurrikulave, nevojën për ndryshime të tilla në kontekstin e kohës bashkëkohore, si dhe ndikimin e ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor, me një theks të veçantë në rëndësinë e shkollës dhe zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve. Në vijim, punimi shqyrton dy koncepte kyçe për arsimin në Shqipëri: **Koncepti për arsim dhe edukim nëntëvjeçar (2007)** dhe **Koncepti për arsim fillor (2021)**, duke i analizuar dhe diskutuar ndryshimet e ndodhura midis këtyre dy periudhave. Pjesa tjetër e kapitullit është e dedikuar për shqyrtimin e **programave mësimore** të implementuara nga viti 2010 deri në 2021, duke përfshirë lëndët e ndryshuara, planet globale dhe tematike, si dhe përgatitjet ditore të mësimdhënësve për këto ndryshime. Kapitulli vazhdon me analizën e **lëndëve të lira zgjedhore** dhe **aktiviteteve jashtëkurrikulare**, duke i shqyrtuar ato në lidhje me adaptimin dhe përgatitjen e mësimdhënësve për ndryshimet kurrikulare. Këtu, gjithashtu diskutohet përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor, raporti midis kurrikulës dhe teknologjisë, si dhe ndikimi i digjitalizimit të teksteve mësimore, duke vlerësuar anët pozitive dhe negative të këtij procesi. Gjithashtu, merret parasysh edhe vlerësimi i kombinuar dhe rëndësia e tij në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Kapitulli i tretë fokusohet në aspektin metodologjik të hulumtimit, duke përshkruar në detaje temën, objektivat dhe detyrat e hulumtimit, pyetjet kërkimore, hipotezat dhe nënhipotezat,

variablat e hulumtimit, instrumentet, metodat e përdorura, si dhe popullacionin dhe kampionin (fq. 123-130). Objektivat dhe detyrat kryesore të këtij studimi janë të sinkronizuara me qëllimin e hulumtimit, që synon analizimin e ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjatë periudhës 2010-2021. Ky studim ka për qëllim jo vetëm paraqitjen dhe përshkrimin e këtyre ndryshimeve, por edhe analizimin e ndikimit të tyre në cilësinë e arsimit fillor, duke u mbështetur në perspektivën e mësimdhënësve, pedagogëve dhe këshilltarëve të BZHA-së. Përfshirja e periudhës 2010-2021 mundësoi analizën e tre koncepteve themelore kurrikulare: Koncepti nëntëvjeçar, Koncepti i Kembrixh dhe Koncepti për arsim fillor të vitëve të fundit. Si variabla të pavarura dhe kontrolluese u përfshinë faktorë të tillë si: shkolla, mosha, niveli arsimor, përvoja, vendbanimi, gjinia dhe ndjekja e trajnimeve. Ndërsa variablat e varura themelore-strukture ishin: Cilësia e arsimit fillor, Cilësia e ndryshimeve kurrikulare, Mbështetja e mësimdhënësve për implementimin e ndryshimeve kurrikulare, dhe Pranueshmëria e ndryshimeve kurrikulare. Variablat e varura përbërëse përfshinin aspekte të tilla si: Avancimi, të kuptuarit, zbatuarshmëria, lehtësia, efektiviteti, kualiteti i aktiviteteve, autonomia, planifikimi, puna administrative, vlerësimi i nxënësve, aktivitetet jashtëmësimore dhe ato të lira. Pyetësi për qëndrimet e mësimdhënësve përmban 25 pyetje dhe 127 ajte të strukturuar në grupe indikatorësh. Grupi i parë përfshin karakteristikat socio-demografike dhe pedagogjike, ndërsa tre klasterat e përshkruara më lart ndihmojnë në vlerësimin e ndryshimeve kurrikulare. Ajtet janë grupuar sipas shkallës së Likert, nga "Aspak e vërtetë" deri në "Shumë e vërtetë" (nga 0-5), duke ofruar një matje të besueshmërisë së instrumentit, i cili ka rezultuar me një koeficient alfa-Cronbach prej 0.78, duke e bërë të pranueshëm për kërkesat metodologjike të studimit. Studimi ka përfshirë gjithashtu intervista me këshilltarët e Byrosë për Zhvillim të Arsimit dhe pedagogët e shkollave, për të mbledhur informacion lidhur me qëndrimet e tyre për ndryshimet kurrikulare. Për këtë qëllim, është përdorur një protokoll interviste i përbërë nga 16 pyetje të hapura, që shqyrtojnë ndikimin, mbështetjen dhe pranueshmërinë e ndryshimeve kurrikulare.

Kapitulli i katërt paraqet analizën dhe prezantimin e rezultateve të hulumtimit. Pas grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave nga pyetësorët dhe intervistat e realizuara, në këtë kapitull paraqiten analizat statistikore dhe ato kualitative për nxjerrjen e konkluzioneve dhe interpretimin e hipotezave dhe nënhipotezave të hulumtimit. Fillimisht, ky kapitull paraqet statistikën socio-demografike të të anketuarve dhe vazhdon me shpërndarjen e variablave dhe interpretimin e hipotezave të hulumtimit.

Sipas të dhënave të grumbulluara, kërkesës për plotësimin e pyetësorëve i janë përgjigjur gjithsej 651 mësimdhënës nga 16 shkolla të katër rajoneve. Një aspekt i rëndësishëm që duhet theksuar është pabaraspesha në numrin e mësimdhënësve të përfshirë në këtë studim. Megjithatë synimi ka qenë të ruhet përpjesëtimi i barabartë të mësimdhënësve nga çdo shkollë, duke parashikuar të fitohen përgjigje nga 40 mësimdhënës nga çdo shkollë, kjo kërkesë nuk është realizuar plotësisht. Ndërsa në shkollën ShFK "Bashkimi" në Gostivar, 52 mësimdhënës janë përgjigjur (që parqet edhe maksimumin), në shkollën ShFK "Anton Zako Çajupi" në Kumanovë, vetëm 31 mësimdhënës e kanë plotësuar pyetësorin.

Në kapitullin e pestë, përfundimi paraqet një shqyrtim të gjetjeve të hulumtimit teorik dhe empirik, duke përfshirë hipotezat dhe rekomandimet. Kurrikulat në sistemet arsimore janë baza e cilësisë së arsimit. Hartimi dhe implementimi i suksesshëm i këtyre kurrikulave çon në rezultate të kënaqshme. Çdo ndryshim kurrikular duhet të kalojë nëpër faza pilotimi, hulumtimi, përmirësimi dhe më pas aplikimi. Për të arritur sukses në realizimin e kurrikulave, është e domosdoshme që të bëhet hulumtim çdo vit shkollor, të identifikohen përparësitë dhe dobësitë, dhe të bëhen ndryshime të domosdoshme për të avancuar në nivele europiane dhe botërore, veçanërisht për brezat e rinj. Ky punim ka shqyrtuar ndryshimet kurrikulare në shkollat fillore në RMV nga viti 2010 deri në 2021, duke krahasuar cilësinë e koncepteve, programeve dhe aplikimin e kurrikulave gjatë kësaj periudhe. Për të arritur këto përfundime, janë analizuar të dhëna teorike dhe empirike, si dhe janë interpretuar hipotezat dhe nënhipotezat.

- Përmes mbështetjes në objektivin e hulumtimit, që përqendrohet në një analizë të thelluar dhe të saktë të ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 2010–2021, u realizua një studim gjithëpërfshirës mbi konceptet kyçe kurrikulare.
- Në këtë kontekst, duke u mbështetur në qëndrimet dhe perspektivat e mësimdhënësve, pedagogëve, këshilltarëve të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe elementët teorikë, u analizuan dokumentet kryesore të politikave arsimore, përfshirë: Konceptin për Edukimin dhe Arsimin Fillor Nëntëvjeçar (2007) dhe Konceptin për Arsimin Fillor (2021), si dokumenti më i fundit i miratuar.
- Për më tepër, studimi shqyrtoi aspekte dhe komponentë kyç të procesit mësimor dhe metodologjisë së zbatimit të kurrikulës, që përfshijnë: programet mësimore për realizimin e mësimin në kontekst global dhe tematik, aktivitetet e lira zgjedhore, lëndët zgjedhore,

format e mësimdhënies përmes librit fizik dhe digjital, si dhe sistemin e vlerësimit të kombinuar.

- Hulumtimi ofroi një pasqyrë të qartë dhe objektive jo vetëm për evoluimin e politikave arsimore, por gjithashtu shqyrtoi dhe shpjegoi ndikimin e këtyre politikave në praktikën mësimore. Shpjegimi i gjetjeve të hulumtimit u realizua në një mënyrë kritike, duke përshkruar efektivitetin dhe sfidat e reformave kurikulare të ndërmarra gjatë kësaj periudhe
- Seksioni i ***Bibliografisë***, përmban burimet e literaturës, të cilat janë përdorur për shtjellimin teorik të këtij studimi.

Në fund, ***Shtojcat***, përmbledhin instrumentet e përdorura për hulumtimin sasior dhe cilësor.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Gjatë hartimit të këtij punimi të doktoratës me titull ***“Ndryshimet kurrikulare në arsim fillor në Republikën e Maqedonisë së veriut prej vitit 2010 deri 2021”*** kandidatja i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën e saj kërkimore-shkencore.

Metodologjia e përdorur në këtë disertacion është e zhvilluar në disa faza dhe mbështetet në studime cilësore dhe sasiore, ndërsa për mbledhjen e të dhënave janë përdorur disa instrumente si: Intervistë e strukturuar, protokoli i vëzhgimit të nivelit të zbatueshmërisë nëpër shkolla fillore, pyetësor për mësimdhënës.

Pasi është përcaktuar problematika e hulumtimit dhe janë konceptualizuar nocionet kryesore bazuar në literaturën shkencore dhe studimet relevante, përcaktohen objektivat dhe detyrat e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, variablat dhe operacionalizimi i tyre, instrumentet e përdorura, popullacioni dhe mostra, si dhe metodat statistikore për analizën e të dhënave.

Objektivat dhe Detyrat e Hulumtimit

Objektivat kryesore të këtij studimi janë në përputhje me qëllimin e tij, i cili ka të bëjë me analizën e ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 2010-2021. Ky studim nuk synon vetëm përshkrimin dhe paraqitjen e këtyre ndryshimeve, por edhe analizimin e ndikimit të tyre në cilësinë e arsimit fillor nga këndvështrimi i mësimdhënësve, pedagogëve dhe këshilltarëve të BZHA-së.

Duke marrë parasysh kohëzgjatjen e analizuar (2010-2021), studimi fokusohet në tre koncepte themelore kurrikulare: **Koncepti Nëntëvjeçar, Koncepti i Kembrixhit dhe Koncepti për**

Arsimin Fillor të viteve të fundit. Për të trajtuar në mënyrë të strukturuar problematikën e hulumtimit, studimi do të udhëhiqet nga detyrat e mëposhtme:

- Vlerësimi i gjendjes së arsimit fillor në periudhat përkatëse dhe identifikimi i nevojave për ristrukturim të sistemit;
- Analiza e procesit teknik dhe metodologjik të ndryshimeve kurrikulare në arsimin fillor;
- Vlerësimi i produktivitetit dhe efektivitetit të koncepteve dhe kurrikulave të zbatuara gjatë periudhave përkatëse, si dhe nevojës për reforma të reja kurrikulare;
- Analiza e ndikimit të ndryshimeve kurrikulare në cilësinë e mësimdhënies në arsimin fillor;
- Vlerësimi i mbështetjes, pranueshmërisë dhe besueshmërisë së kurrikulave nga subjektet arsimore dhe komuniteti më i gjerë;
- Përpunimi dhe sistematizimi i të dhënave të mbledhura përmes instrumenteve dhe teknikave të hulumtimit (përfshirë tabela, grafikë dhe të dhëna statistikore);
- Hartimi i rekomandimeve që mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit, si dhe në rritjen e mbështetjes dhe pranueshmërisë së kurrikulave aktuale nga aktorët relevantë arsimor.

Duke u bazuar në objektivat dhe detyrat e hulumtimit, si dhe në gjetjet e studimeve të mëparshme mbi problematikën në fjalë, janë formuluar pyetjet kërkimore të mëposhtme:

A kanë ndikuar ndryshimet kurrikulare të periudhës 2010-2021 në përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

A ekzistojnë dallime të rëndësishme në qëndrimet e mësimdhënësve mbi cilësinë e koncepteve dhe kurrikulave të zbatuara gjatë periudhës 2010-2021?

A kanë pasur mësimdhënësit mbështetje të mjaftueshme për implementimin e ndryshimeve kurrikulare?

Cili është niveli i pranueshmërisë dhe arsyetimit të ndryshimeve të kësaj periudhe nga perspektiva e mësimdhënësve?

A ka dallime statistikisht të rëndësishme në qëndrimet e mësimdhënësve mbi cilësinë, mbështetjen dhe pranueshmërinë e ndryshimeve kurrikulare, në varësi të karakteristikave të tyre socio-demografike dhe profesionale?

Hipotezat e Hulumtimit

Në përputhje me pyetjet kërkimore të formuluar, punimi përmban gjashtë hipoteza të përgjithshme dhe të detajuara për studimin.

Variablat e Hulumtimit

Në këtë studim janë identifikuar shtatë variabla të pavarura (kontrolluese), katër variabla të varura kryesore dhe nëntë variabla të varura sekondare.

Metodologjia e Hulumtimit

Nga pikëpamja metodologjike, ky studim mbështetet në një qasje të kombinuar kërkimore, duke integruar metoda të përgjithshme dhe specifike të hulumtimit për të analizuar ndikimin e ndryshimeve kurrikulare gjatë periudhës 2010-2021.

Metodat e Përgjithshme të Hulumtimit

Metoda induktive – mbledhja e të dhënave përmes kërkimeve në terren.

Metoda deduktive – analizimi i literaturës shkencore ekzistuese për të ndërtuar bazën teorike të studimit.

Metodat Specifike të Hulumtimit

Metoda e analizës teorike – për të shqyrtuar dhe krahasuar rrjedhën e ndryshimeve kurrikulare përgjatë periudhës së analizuar.

Metoda statistikore – për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave duke përdorur teknika të përparuara statistikore.

Metoda komparative – për të krahasuar ndryshimet kurrikulare në intervalin kohor 2010-2021.

Metoda deskriptive – për të përshkruar gjetjet e studimit në aspektin e cilësisë së arsimit fillor, mbështetjes për implementimin e reformave dhe perceptimeve të mësimeve.

Metodat Statistikore për Interpretimin e Hipotezave

Interpretimi i hipotezave bazohet në analiza statistikore deskriptive dhe inferenciale:

Hipoteza Gjenerale është interpretuar përmes analizës së të dhënave nga tre kategori kryesore:

Perceptimi i mësimeve për kurrikulat (2010-2021)

Mbështetja institucionale për zbatimin e ndryshimeve kurrikulare

Pranueshmëria dhe besueshmëria e reformave nga mësimeve.

Të dhënat janë të strukturuar sipas shkallës Likert (1-5), duke lejuar krahasimin e mesatareve të fituara me mesataret teorike për të vlerësuar perceptimin, mbështetjen dhe pranueshmërinë e reformave.

Popullata dhe Kampioni

Ky studim përfshin një kampion të përzgjedhur nga mësimeve e arsimit fillor, pedagogët shkollorë dhe këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA). Përfaqësimi gjeografik dhe shpërndarja sipas komunave e gjithsej 651 mësimeve, 16 pedagogëve dhe 10 këshilltarëve

të BZhA-së, është si dhënë si në vijim: Gostivar: 176 mësimdhënës, Tetovë: 172 mësimdhënës, Shkup: 153 mësimdhënës, Kumanovë: 150 mësimdhënës

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Rezultatet e këtij hulumtimi, të analizuara në përputhje me hipotezat e parashtruara, ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi nivelin e zbatimit të ndryshimeve kurrikulare dhe adresojnë pyetjet kërkimore të studimit. Përmbledhja dhe interpretimi i të dhënave mundësojnë konfirmimin ose hedhjen poshtë të hipotezave të formuluar.

Analiza statistikore konfirmon se rreth 70% e mësimdhënësve kanë ndjekur trajnimet e organizuara nga MASH, ndërsa 30% e kanë refuzuar për arsye personale ose përvojë profesionale. Qëndrimi ndaj Konceptit për Arsim Fillor 2021 është më pozitiv krahasuar me modelet e mëparshme, ndonëse perceptimet për cilësinë e programeve mbeten të përziera, me dominim të vlerësimeve mesatare ose të ulëta.

Sa i përket **mbështetjes institucionale dhe trajnimeve**, shumica e mësimdhënësve ndjejnë mungesë mbështetjeje adekuate, qoftë nga dokumentet zyrtare, udhëzuesit apo këshilltarët arsimorë. Përkundër deklaratave të këshilltarëve të BZHA mbi ofrimin e ndihmës, mësimdhënësit i kanë mohuar këto pretendime, duke ngritur dilema mbi efektivitetin e mbështetjes.

Faktorët demografikë si vendbanimi, mosha, niveli arsimor dhe gjinia nuk ndikojnë ndjeshëm në perceptimin e cilësisë, mbështetjes dhe pranueshmërisë së ndryshimeve kurrikulare. Megjithatë, përvoja profesionale paraqitet si një faktor i rëndësishëm: mësimdhënësit me 6-20 vjet përvojë kanë një qëndrim më pozitiv krahasuar me ata me më pak se 5 ose më shumë se 21 vjet përvojë. Ndjekja e trajnimeve nuk ka ndikuar ndjeshëm në perceptimin e mbështetjes gjatë implementimit të reformave. Megjithatë, ka një **dallim të rëndësishëm statistikisht** në perceptimin e cilësisë: pjesëmarrësit në trajnime shfaqin qëndrime më pozitive. Në mënyrë paradoksale, mësimdhënësit që nuk kanë ndjekur trajnimet shfaqin një nivel më të lartë pranueshmërie ndaj reformave, ndërsa ata që i kanë ndjekur mbeten më skeptikë.

Kontributet kryesore shkencore të kandidates:

Konsiderojmë se kandidatja ka dhënë kontribut të duhur në analizën e detajuar në punimin e disertacionit dhe se ky punim shkencor do të kontribuojë në fushën e pedagogjisë, sepse hulumton në mënyrë të thelluar ndryshimet kurrikulare në arsimin fillor, një aspekt i rëndësishëm për politikat arsimore dhe praktikën mësimore. Hulumtimi pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen

shkollat, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore në vend, mungesat konkrete, duke ofruar kështu një bazë të dhënash për përmirësime të mëtejshme sistimore. Rekomandimet e nxjerra nga ky hulumtim, përfshirë nevojën për trajnime dhe furnizime didaktike, janë bazë për hartimin e politikave arsimore që synojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Punimi vë në dukje domosdoshmërinë që ndryshimet në kurrikulë duhet të jenë një temë e vazhdueshme në agjendën e takimeve, ndërsa trajnimet për kurrikulën duhet të ofrohen në mënyrë të përsëritur për aq kohë sa është e nevojshme. Theks i veçantë vendoset edhe te pasiguria e mësimdhënësve lidhur me aftësitë e tyre për të përballuar këto ndryshime që jep mundësi për planifikim për rolin e mentorimit, veçanërisht për mësuesit e rinj.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:


Në bazë të përfundimeve të nxjerra nga studimi i realizuar nga kandidatja Mr.sc. Rabije Osmani me titull *“Ndryshimet kurrikulare në arsim fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej vitit 2010 deri në vitin 2021”*, për studime të mëtejshme rekomandohet të bëhen hulumtime më të thelluara që do të përfshinin përpilimin e koncepteve të arsimit fillor me përfshirje të detyrave dhe obligimet për çdo cikël shkollor në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, përpilimin e Udhëzuesve dhe Doracakëve më të qartë, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kurrikulave ekzistuese duke analizuar kurrikulat aktuale për të identifikuar përparësitë dhe mangësitë para zbatimit të ndryshimeve, pilotimin e kurrikulave të reja përmes testimit në shkolla urbane dhe rurale për të adresuar sfidat para zbatimit të gjerë, trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit, angazhimin e këshilltarëve të specializuar rajonal për lëndët përkatëse në secilin rajon, harmonizimin e Ligjeve me ndryshimet kurrikulare, përfshirjen e mësimdhënësve në procesin e ndryshimeve kurrikulare, e shumë të tjera.

Këto rekomandime synojnë të rrisin efektivitetin e reformave kurrikulare dhe të mbështesin mësimdhënësit në zbatimin e tyre.

Vlerësim dhe propozim

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës **“Ndryshimet kurrikulare në arsim fillor në Republikën e Maqedonisë së veriut prej vitit 2010 deri 2021”**, të kandidates Mr. sc. Rabije Osmani, konstaton se punimi në fjalë i plotëson të gjitha kushtet të parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës dhe ka nderin që t’i propozojë Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof.dr. Besa Dogani (kryetar) 
2. Prof.dr. Rabije Murati (anëtar) 
3. Prof.dr. Lulzim Mehmedi (anëtar) 
4. Prof.dr. Besa Havziu Ismaili (anëtar) 
5. Prof.dr. Valdet Zenuni Idrizi (anëtar) 

Tetovë, 15.04.2025